



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 1190/5 Prot.

Tiranë, më 21.12.2018

V E N D I M

Nr. 237, Datë 21.12.2018

PËR

AUDITIMIN E "PËRPUTHSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË"
TË USHTRUAR NË ALBCONTROL SHA TIRANË
për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datë 31.08.2018.

Nga auditimi i ushtruar në shoqërinë "Albcontrol" SHA Tiranë, rezultoi që kishte përmirësim të treguesve ekonomiko-financiarë, megjithëse u konstatuan disa mangësi dhe shkelje të dispozitave ligjore.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të Ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Auditim Përputhshmërie dhe Ligjshmërie", të ushtruar në shoqërinë "Albcontrol" SHA Tiranë, sipas programit të auditimit nr. 1190, datë 23.10.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datë 31.08.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për Opinionin e auditimit

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 24.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-^{së}”, në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-^{së}, si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të përputhshmërisë të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga shoqëria “Albcontrol” SHA Tiranë dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Opinion i kualifikuar

“Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) së KLSH-së, i kryer në subjektin – Albcontrol SHA, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë të përhapura dhe nuk janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënie opinionin të kualifikuar”

Baza për konkluzionin/opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 400¹ dhe 4100²):

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga shoqëria “Albcontrol”SHA Tiranë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura.

Opinion i kualifikuar me rezervë:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin shoqëria “Albcontrol” SHA Tiranë, rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) në administrimin e shpenzimeve dhe të ardhurave, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë prekur ***nga gabime materiale***, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionin të kualifikuar me rezervë***³.

¹ ISSAI 400(Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë.

²ISSAI 4100 “Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare”

³ Kur audituesit konkludojnë se ka devijime materiale, opinionin i shprehur është me rezerve(N.q.s. devijimet janë materiale por jo të përhapura ose audituesit nuk janë në gjendje të sigurojnë të dhëna (evidencë)të mjaftueshme dhe të përshtatshme dhe efektet e mundshme janë materiale por jo të përhapura).

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Gjetje nga auditimi:

Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

1.1 Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi u konstatua se:*

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Albcontrol SHA, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 8/5, dt. 08.04.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara. Me urdhrin e Titullarit nr. 575., dt. 01.04.2016 dhe urdhrin nr. 575/1, datë 01.04.2016, është ngritur grupi i punës për analizimin e gjetjeve dhe rekomandimet e KLSH-së, i cili ka pasur për detyrë të raportonte për zbatimin e rekomandimeve e KLSH, në zbatim të programit të miratuar nga titullari i subjektit.

-Albcontrol SHA, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH, në kundërshtim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Masa Organizative: Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **9 masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht **9**, janë zbatuar plotësisht **2**, janë në proces **2** dhe të pa zbatuara janë **5** rekomandime (*Trajtuar më hollësisht në faqet 5-8, të raportit të auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.

Në vazhdimësi

Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua që:

2.1 Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se në dosjet e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, nuk janë njoftimet zyrtare për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës në kundërshtim me nenin 20, pika 2/a të statutit të Albcontrol SHA, për periudhën objekt auditimi.

-Në dosjet e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, nuk ka përcaktim të rendit të ditës së mbledhjes, mbi bazën e programit vjetor të miratuar të shoqërisë, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të statutit të Albcontrol SHA për periudhën objekt auditimi (*Trajtuar më hollësisht në faqet 8-12, të raportit të auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë në të ardhmen duhet të marrë masa që në përputhje me programin vjetor të miratuar të shoqërisë, të përcaktojë rendin e ditës për çdo mbledhje i cili duhet të jetë në sinkron me njoftimet zyrtare, që duhet të jenë pjesë e dosjeve të Këshillit Mbikëqyrës.

Në vazhdimësi

Nga auditim mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese të Albcontrol SHA, Këshilli Mbikëqyrës dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, u konstatua që:

3.1 Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumenteve të programit ekonomik financiar për vitin 2017, i dërguar dhe miratuar me Vendimin nr. 14, datë 23.12.2016 të Këshillit Mbikëqyrës dhe i miratuar nga MZHETS, me shkresën nr. 10080/2, datë 26.01.2017 u konstatua se zëri i investimeve të mbartura të parashikuara në këtë program ishte në vlerën 176,352,000 lekë. Në shkresën me nr. 867 prot, datë 18.04.2018, mbi realizimet e zërave të parashikuara në programin ekonomik për vitin 2017, që ALBCONTROL SHA. i ka dërguar Këshillit Mbikëqyrës dhe Ministrin të Linjës, në zërin investime të mbartura të parashikuara vlera e paraqitur është 142,674,000 lekë. Vlera e investuar në fund të vitit për këtë zë është 194,182,000 lekë. Me ndryshimin e vlerës nga 176,352,000 lekë e parashikuar në programin ekonomik në fillim me vlerën 142,674,000 lekë, i është paraqitur në mënyrë jo reale përqindja e investimeve të kryera, Këshillit Mbikëqyrës dhe Ministrin të Linjës (*Trajtuar më hollësisht në faqet 12-26, të raportit të auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, duhet të marrë masa, që hartimi i raporteve të treguesve ekonomik të shoqërisë që shqyrtohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe aksionari për vendim-marrje, të kryhet në mënyrë të saktë, dhe me shpjegimet përkatëse duke bërë analiza periodike për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet.

Në vazhdimësi

Nga auditimi mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj), u konstatua që:

4.1 Gjetje nga auditimi: Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave në disa blerje me vlerë të vogël, ka pranuar mallra që kishin mospërputhje në cilësinë, llojshmërinë dhe qenien e plotë të kërkuar në ofertën e prokuruar.

- Në procedurën e iniciuar me urdhër prokurimin nr.15, datë 29.02.2016, me proces verbalin e mbajtur për marrjen në dorëzim të mallit të faturës tatimore me vlerë 592,440 lekë me TVSH, me nr. 133217959, datë 02.03.2016, komisioni i marrjes në dorëzim, është shprehur se malli i plotëson të gjitha kushtet teknike, cilësore dhe sasiore në përputhje me përshkrimin e urdhrin të prokurimit. Nga shqyrtimi i faturës tatimore të mësipërme si dhe manualit, rezultoi se tipi i televizorit të blerë ishte LED dhe jo OLED si dhe nuk ishin të përfshirë programi i Skype bashkë me kamera tip AN-VC500, audio e kërkuar nga 40W ishte në 20W. Komisioni i marrjes në dorëzim duhet të mos e pranonte mallin e sjellë nga furnitori pasi nuk plotësonte kërkesat teknike të kërkuara në urdhrin e prokurimit.

- Në procedurën e iniciuar me urdhër prokurimin nr.91, datë 18.12.2017, me proces verbalin e mbajtur për marrjen në dorëzim të mallit 50 ml moket poliamid, me nr. prot. ex, datë 03.01.2018, dorëzuar nga operatori ekonomik G..., me faturën nr.145, datë 29.12.2017, me vlerë 920,400 lekë me TVSH, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave është shprehur se mallrat e marra në dorëzim plotësojnë të gjitha kushtet teknike, cilësore dhe sasiore të kërkuara. Në dokumentet e dosjes nuk u konstatua

asnjë certifikatë për të vërtetuar plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara në procesin e prokurimit.

Veprimet e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave janë në kundërshtim me pikën 45 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-37, të raportit të auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave, të kryejnë verifikimet e duhura që mallrat e sjellë nga furnitorët, të plotësojnë të gjitha specifikimet teknike e cilësore të kërkuara në procedurën e blerjes, si një pjesë e rëndësishme e rritjes së efijencës dhe efektivitetit të investimeve të shoqërisë.

Në vazhdimësi

5.1 Gjetje nga auditimi: Nga Komisioni i blerjeve me vlera të vogla, në procedurën me Urdhër Prokurimi nr.74, datë 24.10.2017, me vlerë 775,070 lekë, pa Tvsh, për blerje kabëll koaksial, 2 copë antena VHF, suport metalik për bazamentin e antenës si dhe instalimin në kullë dhe testimin e linjës së transmetimit, hartimi i specifikimeve teknike për antenat është kryer jo i plotë pa u përcaktuar frekuenca, sistemi i përdorimit, fusha e përhapjes si dhe duke e publikuar markën e kërkuar, Sirio, pa dhënë shpjegimet përkatëse si dhe vendosjen e mundësive alternative. Veprimet më sipër janë në kundërshtim me nenin 27, të VKM 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-37 të raportit të auditimit*).

5.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, të marrë masa për organizimin e trajnimeve në fushën e prokurimit publik, për anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla, që të përdorin specifikime teknike që përshkruajnë në minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, duke garantuar cilësinë e kërkuar të mallrave, shërbimeve apo punëve publike që prokuron autoriteti kontraktor.

Në vazhdimësi

6.1 Gjetje nga auditimi: Me Urdhër Prokurimi nr.22, datë 02.03.2017, është iniciuar procedura e prokurimit me vlerë 242,133 lekë, pa Tvsh, për punime çmontimi dhe rimontimi të konstruksioneve metalike, demontimi dhe instalimi i antenave radio si dhe raport vlerësimi për përhapjen elektromagnetike të sinjalit të radarit. Në ftesën për ofertë të datës 02.03.2017, në specifikimet teknike kërkohet që OE, të jetë i certifikuar për punime në lartësi, të ketë eksperiencë të ngjashme në instalimin e antenave, rrufepritësve, duke paraqitur kontrata të ngjashme të realizuara, si dhe të ketë një staf të kualifikuar me të paktën një inxhinier të telekomunikacionit. Kërkesa që subjekti të jetë i certifikuar për punime në lartësi është e përgjithshme dhe e paqartë duke mos specifikuar se çfarë certifikate duhet të ketë subjekti dhe cili autoritet e lëshon.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se OE fitues, nuk ishte i certifikuar për punime në lartësi. Gjithashtu në dokumentacion mungonte evidenca që subjekti ka të punësuar një inxhinier të telekomunikacionit. Lidhur me eksperiencën e ngjashme subjekti fitues ka paraqitur një fotokopje të pa-noterizuar të një fature shërbimi që nuk ka ngjashmëri me objektin e prokuruar. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk duhet të shpallte fitues subjektin Rebeqa Konstruksion, duke vazhduar procesin me operatorë të tjerë ose duke e rifilluar procedurën.

-Me urdhrin e prokurimit nr. 61, datë 14.09.2017, është iniciuar procedura e blerjes së set fotokurtine për ashensor me fond limit 697.667 lekë pa Tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në dosje, të operatorit ekonomik fitues, u konstatua se mungonte autorizimi nga kontraktori i mirëmbajtjes së shërbimeve periodike profilaktike në Albcontrol SHA., certifikatat e kërkuara ishin fotokopje jo të noterizuara, subjekti nuk kishte në ekstraktin e regjistrit historik, në aktivitetin tregtar objektin e kësaj procedure dhe lidhur me personelin e kualifikuar që OE duhet të zotëronte nuk ishin paraqitur listë pagesat e deklaruara në sistemin tatimor për të vërtetuar punësimin e tyre.

Për sa më sipër komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk duhet të shpallte fitues subjektin A....SHPK, duke vazhduar procesin me operatorë të tjerë ose duke e rifilluar procedurën siç parashikohet në LPP (*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-37, të raportit të auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Prokurimit të marrë masa që Komisionet e prokurimit me vlera të vogla në të ardhmen, t'i kushtojnë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe certifikata të lëshuara nga organe kompetente. Ky proces ka një rëndësi të veçantë për zbatimin e parimit të ekonomicitetit në shfrytëzimin e fondeve të shoqërisë.

Në vazhdimësi

7.1 Gjetje nga auditimi: Në auditimin me zgjedhje të dietave të punonjësve kur kanë qenë me shërbim jashtë vendit, është vërejtur se në disa prej shërbimeve të kryera, mungon kopja e aplikimit për pjesëmarrjen në aktivitete në kundërshtim me VKM nr.870 datë 14.12.2011, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", Udhëzimi nr.22, datë 10.07.2013 (*Trajtuar më hollësisht në faqen 29-37, të raportit të auditimit*).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, duhet të marrë masa që punonjësit e shoqërisë të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme jashtë vendit, bashkëlidhur me dokumentat e tjera të dorëzojnë në njësinë përgjegjëse, kopje të aplikimit për pjesëmarrjen në evenimente si dhe nëse marrin, të certifikatave ose diplomave përkatëse.

Në vazhdimësi

Nga auditimi mbi organizimin dhe mbajtjen e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të Albcontrol SHA., si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet eprorë. Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore, u konstatua që:

8.1 Gjetje nga auditimi: Në hartimin e pasqyrave financiare, shoqëria nuk ka shqyrtuar vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të aktiveve afatgjata materiale, në veçanti makineritë, pajisjet dhe sistemet monitoruese që kanë vlera të konsiderueshme

materiale dhe që janë të lidhura me zhvillimet dhe përditësimet e detyrueshme teknologjike të detyrueshme nga mjedisi ku shoqëria operon. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16 ku citohet: *“Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e një aktivi do të rishihet të paktën çdo fund-viti financiar dhe nëse pritshmëria ndryshon nga parashikimet e mëparshme, ndryshimet do të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël në përputhje me SNK 8, Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet.”* Duke u nisur nga detyrimet e shoqërisë për të siguruar një sistem monitorimi të trafikut ajror, i harmonizuar me atë të Eurocontrol-it, si dhe zhvillimet bashkëkohore të teknologjisë, vlerësimi dhe pritshmëria e jetës së dobishme të makinerive dhe pajisjeve të lidhura me këto sisteme, është e rëndësishme sepse informon drejtimin për kërkesat e ardhshme për investime (*Trajtuar më hollësisht në faqet 37-66 të raportit të auditimit*).

8.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa për rishikimin e vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të makinerive, pajisjeve që influencohen nga zhvillimi teknologjik, dhe nëse pritshmëria e tyre ndryshon nga parashikimet e mëparshme, të kryejë ndryshimet e duhura. Këto veprime janë pjesë e rëndësishme për hartimin e pasqyrave financiare, për planifikimin, zbatimin e programit ekonomik si dhe kërkesat e ardhshme për investime.

Në vazhdimësi

9.1 Gjetje nga auditimi: Në shënimet shpjeguese nga drejtimi i shoqërisë nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve me vlera materiale, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore. Zgjedhje e metodës së amortizimit dhe vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve është çështje gjykimi. Informacioni shpjegues për metodat e përdorura dhe vlerësimet e kryera është i rëndësishëm për shqyrtimin e politikave të zgjedhura nga drejtimi, nga përdoruesit e pasqyrave financiare.

-Përcaktimi i jetës së dobishme të Aktiveve Afatgjata Materiale është pjesë e politikës së menaxhimit të tyre nga drejtimi i shoqërisë, që kërkon një gjykim të caktuar bazuar në eksperiencën e shoqërisë me aktive të ngjashme, siç përcaktohet dhe në pikën 57 të SNK 16, *“Jeta e dobishme e një aktivi përcaktohet në termat e dobishmërisë së pritshme të aktivitetit për njësinë ekonomike. Politika e menaxhimit të aktiveve të njësisë ekonomike mund të përfshijë nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve pas një kohe të caktuar ose pas konsumit të një pjese të caktuar të përfitimeve ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktiv. Prandaj jeta e dobishme e një aktivi mund të jetë më e shkurtër sesa jeta ekonomike e tij. Vlerësimi i jetës së dobishme të aktivitetit është çështje gjykimi bazuar në eksperiencën e njësisë ekonomike me aktive të ngjashme.”* Këto veprime janë bërë në kundërshtim me pikat 75 e 76 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivitet Afatgjata Materiale ku citohet: *“Zgjedhja e metodës së amortizimit dhe vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve është çështje gjykimi. Prandaj dhënia e informacioneve shpjeguese për metodat e përdorura dhe vlerësimet e jetëve të dobishme ose të normave të amortizimit, u siguron përdoruesve të pasqyrave financiare informacion që i lejon ata të shqyrtojnë politikat e zgjedhura nga drejtimi dhe mundëson krahasimin me njësi të tjera ekonomike., dhe pika 76, në përputhje me SNK 8 një njësi ekonomike jep informacion shpjegues për*

natyrën dhe efektin e një ndryshimi në vlerësimin kontabël që ka efekt në periudhën aktuale ose pritet të ketë efekt në periudhat e mëpasshme. Dhënia e këtyre informacioneve shpjeguese për aktivet afatgjata materiale mund vijë nga ndryshimet në lidhje me: (a) vlerat e mbetura; (b) kostot e vlerësuara të zberthimit, heqjes ose rikrijimit të zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje); (c) jetët e dobishme; dhe (d) metodat e amortizimit (Trajtuar më hollësisht në faqet 37-66, të raportit të auditimit).

9.1 Rekomandimi: Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në shënimet shpjeguese e pasqyrave financiare, të paraqiten informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve me vlera materiale, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore, si një pjesë e rëndësishme për përdoruesit e tyre, për vlerësimin e politikave kontabël të zgjedhura nga drejtimi.

Në vazhdimësi

10.1 Gjetje nga auditimi: Shoqëria nuk ka përditësuar në Regjistrin Kombëtar, të QKB-së, ndryshimin e emrit të pronarit, pasi në ekstraktin historik paraqitet si pronar METE, ndërkohë që aksionari i vetëm është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, veprime që janë në kundërshtim me nenin 43, regjistrimet e tjera të detyrueshme, të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar me Ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015, ku citohet: ” Çdo subjekt, që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër, sipas seksionit III.” (Trajtuar më hollësisht në faqet 37-66, të raportit të auditimit).

10.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i shoqërisë, të marrë masa për kryerjen e regjistrimit të ndryshimit të emërtimit të aksionerit të vetëm në Regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Menjëherë

11.1 Gjetje nga auditimi: Shoqëria nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me të gjitha kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër si datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, mbajtjen në mënyrë shkresore të tij, veprime në kundërshtim me pikën 30, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, ku citohet: “*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia*” (Trajtuar më hollësisht në faqet 37-66, të raportit të auditimit).

11.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtorja e financës e shoqërisë, të marrin masa për plotësimin e regjistrimit të aktiveve me të gjitha kërkesat që duhet të ketë si dhe disponimin e tij, në mënyrë shkresore, si një pjesë e rëndësishme e menaxhimit të aktiveve.

Në vazhdimësi

Nga auditimi me zgjedhje i 22 procedurave mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatim kontratash për periudhën, nga data 01.01.2016 deri më datë 31.08.2018, u konstatua që:

12.1 Gjetje nga auditimi:

-Për **5 procedura prokurimi**, në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

- Në **5 procedura prokurimi**, specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime (*Trajtuar më hollësisht në faqen 66-116, të raportit të auditimit*).

12.1 Rekomandimi: Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj:

-Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve civile, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve, sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Këto kërkesa duhet të kenë në konsideratë edhe faktin që të kushtëzojnë kualifikimin e operatorëve në vartësi të shlyerjes/ose jo të detyrimeve financiare ndaj Albcontrol SHA, zgjidhjes së njëanshme të kontratave, ose mos përmbushjes të të gjitha detyrimeve kontraktore.

Në vazhdimësi

12.2 Gjetje nga auditimi:

Për **11 procedura prokurimi**, Autoriteti Kontraktor dhe konkretisht në kontratat e shpallura së bashku me dokumentet standarde të tenderit (Shtojca 17, neni 9, pika 9.1), nuk parashikohet detyrimi i Autoritetit Kontraktor, për t'i shlyer operatorit fitues paradhënie për zbatimin e kontratës. Ndërsa në kontratat, e nënshkruara midis palëve, në nenin 4 përcaktohet se: “Sipërmarrësi do të marrë një pagesë paraprake në masën

prej 30% të vlerës totale të kontratës”, duke shkelur kështu barazinë midis operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 66-116, të raportit të auditimit*).

12.2 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, të marrë masa që në të ardhmen të analizojë dhe të përcaktojë në kushtet e kontratës / dokumentet standarde të tenderit, termat e referencës dhe të mos i ndryshojë ato gjatë nënshkrimit të kontratave me operatorët ekonomikë, për të siguruar transparencë dhe barazi midis operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në vazhdimësi

Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje e pajisjes ILS për implementimin e procedurës RW 36”, u konstatua që:

13.1 Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje e pajisjes ILS për implementimin e procedurës RW 36”** sipas kontratës nr. 1646/4 prot., datë 16.03.2016 midis ALBCONTROL SHA me përfaqësues titullarin e autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “T...” SHPK **me vlerë 133,741,320 lekë** me tvsh u konstatua se KVO ka kualifikuar ofertën anomalisht të ulët. Pasi i janë kërkuar sqarime operatorit ekonomik “T...” SHPK me ofertën anomalisht të ulët, ky i fundit, i dërgon ALBCONTROL SHA, shkresën me sqarimet përkatëse. Tek kjo shkresë, paraqiten shpjegime lidhur me eksperiencat e mëparshme të këtij operatori. Nuk paraqitet bashkangjitur shkresës asnjë fakt ose argument ligjor konform nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, e ndryshuar, pika 5 ku përcaktohet se “...në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së”. Pra pretendimet e operatorit ekonomik nuk janë të vërtetuara me dokumenta shkresorë e si të tilla nuk përbëjnë prova ose fakte ligjore për tu marrë për bazë. Gjithsesi, KVO ka vazhduar shqyrtimin e ofertës.

-Nga verifikimi i dokumentave financiare të dosjes teknike lidhur me ekzekutimin e kontratës së lidhur, nuk u konstatua asnjë akt marrje në dorëzim të punimeve/shërbimeve si dhe asnjë likuidim për llogari të operatorit ekonomik “T...” SHPK. Si rrjedhojë, afatet e ekzekutimit të kontratës janë tejkaluar dhe zërat e preventivit të parashikuar në kontratë nuk janë zbatuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 66-116, të raportit të auditimit*).

13.1Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, duhet të marrë masa që në vazhdimësi, në vlerësimin e ofertave të ardhura për ofertat anomalisht të ulta, të jetë i kujdesshëm që të kualifikojë ato operatorë ekonomik, që kanë dhënë mjaftueshëm sqarime lidhur me anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, të vërtetuara këto me prova shkresore në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi.

13.2Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për evidentimin e përgjegjësive dhe të merren vendimet përkatëse, mbi shkaqet dhe arsyet e mosekzekutimit të kontratës me objekt “Blerje e pajisjes ILS për implementimin e

procedurës RW 36”, pavarësisht se nuk është kryer asnjë pagesë nga Autoriteti Kontraktor.

Menjëherë

Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua që:

14. Gjetje nga auditimi: Nga ana e njësisë së auditit të brendshëm nuk është dërguar në Ministrinë e Financave deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti vjetor për cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK për vitin 2017, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 116-118, të raportit të auditimit*).

14.1 Rekomandimi:Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë gjatë veprimtarisë së tij të marrë masa për të kontrolluar veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm në zbatim të Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009, për përmirësimin e situatës në mënyrë që kontrollet e brendshme të kenë fushë më të gjerë veprimi dhe të kenë impakt më të madh në ecurinë e shoqërisë mbi menaxhimin financiar të kontrollit.

Në vazhdimësi

15.1 Gjetje nga auditimi : Shoqëria Albcontrol SHA, nuk ka zbatuar shkronjën “b” të nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë”derdhur në Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën 1 % të fondit të pagave për vitin 2016, 2017 dhe 8 mujori 2018 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 119-120, të raportit të auditimit*).

15.1 Rekomandimi: Shoqëria Albcontrol SHA, të marrë masat për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë, llogaritjen e vlerës së 1 % të fondit të pagave për vitin 2016 , 2017 dhe 8 mujori 2018, si dhe arkëtimin për llogari të Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë.

Menjëherë

C.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1 Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje e pajisjes ILS për implementimin e procedurës RW 36”, është lidhur kontrata nr. 1646/4 prot., datë 16.03.2016 midis ALBCONTROL SHA me përfaqësues titullarin e autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “T...” SHPK. Vlera e kontratës është 133,741,320 lekë me tvsh dhe afati i ekzekutimit është 7 muaj nga data e lidhjes së kontratës ose nga data 13.03.2016 deri në datën 13.10.2016. Nga auditimi i zbatimit të kësaj procedure, nuk u konstatua asnjë likuidim nga autoriteti kontraktor për llogari të

operatorit ekonomik “T...” SHPK si dhe asnjë akt marrje në dorëzim të punimeve/shërbimeve që duhej të kryheshin sipas kushteve të kontratës. Afatet e ekzekutimit të kontratës janë tejkaluar dhe zërat e preventivit të parashikuar në kontratë nuk janë ekzekutuar Si rezultat referuar Dokumenteve Standarte të Tenderit “Kushtet e Kontratës” shtojca 16, neni 24 “Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar”, vlera e penaltetit që duhet t’i mbahet operatorit ekonomik “T...” SHPK, për mosekzekutim të zërave të punimeve sipas preventivit, është jo më pak se 25 % e vlerës së kontratës ose **33,435,330 lekë i cili konsiderohet dëm ekonomik** për Albcontrol SHA dhe Buxhetin e Shtetit (*Trajtuar më hollësisht në faqen 66-116, të raportit të auditimit*).

1.1- Rekomandimi: *Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë Albcontrol SHA dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 33,435,330 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shoqërisë dhe që i përket penaltetit që i duhet mbajtur operatorit ekonomik “T...” SHPK, për arsye të mosekzekutimit të zërave të punimeve sipas preventivit dhe të tejkalimit të afateve të kontratës nr. 1646/4 prot., datë 16.03.2016 midis ALBCONTROL SHA me përfaqësues titullarin e autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “T...” SHPK.*

Menjëherë

D.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1 Gjetje nga auditimi: Nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave në disa blerje me vlerë të vogël, janë pranuar mallra që kishin mospërputhje në cilësinë, llojshmërinë dhe qenien e plotë të kërkuar në ofertën e prokuruar.

- Në procedurën e iniciuar me urdhër prokurimin nr.15, datë 29.02.2016, me proces verbalin e mbajtur për marrjen në dorëzim të mallit të faturës tatimore me vlerë 592,440 lekë me TVSH, me nr. 133217959, datë 02.03.2016, komisioni i marrjes në dorëzim, është shprehur se malli i plotëson të gjitha kushtet teknike, cilësore dhe sasiore në përputhje me përshkrimin e urdhrin të prokurimit. Nga shqyrtimi i faturës tatimore të mësipërme si dhe manualit, rezultoi se tipi i televizorit të blerë ishte LED dhe jo OLED si dhe nuk ishin të përfshirë programi i Skype bashkë me kamera tip AN-VC500, audio e kërkuar nga 40W ishte në 20W. Komisioni i marrjes në dorëzim duhet të mos e pranonte mallin e sjellë nga furnitori pasi nuk plotësonte kërkesat teknike të kërkuara në urdhrin e prokurimit.

- Në procedurën e iniciuar me urdhër prokurimin nr.91, datë 18.12.2017, në proces verbalin e mbajtur për marrjen në dorëzim të mallit 50 ml moket poliamid, me nr. prot. ex, datë 03.01.2018, dorëzuar nga operatori ekonomik Golden Casa, me faturën nr.145, datë 29.12.2017, me vlerë 920,400 lekë me TVSH, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave është shprehur se mallrat e marra në dorëzim plotësojnë të gjitha kushtet teknike, cilësore dhe sasiore të kërkuara. Në dokumentet e dosjes nuk u konstatua asnjë certifikatë për të vërtetuar specifikimet teknike e kërkuara në procesin e prokurimit. **Vlera 1,512,840 lekë përbën efekt ekonomik negativ për shoqërinë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-37, të raportit të auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **1,512,840 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit me blerje të vogla “Blerje TV Led” me vlerë 592,440 lekë me TVSH, për vitin 2016 dhe “Blerje Mokat Poliamid, për vitin 2017 me vlerë 920,400 lekë me TVSH si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt ekonomik negativ** për Shoqërinë.

Menjëherë

E.1 MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kontratës Kolektive të Punës neni 38, si dhe kontratave individuale të punës, neni 14, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë Albcontrol SHA, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojë procedurat administrative për dhënien e masave disiplinore nga “*Vërejtje me shkrim*” deri në “*Largim nga Puna*” sipas vlerësimit të nivelit të përgjegjësisë, për nëpunësit e shoqërisë që kanë qenë pjesë e komisioneve të blerjeve me vlera të vogla, njësi prokurimi dhe grupet e marrjes në dorëzim në procedurat e prokurimit të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 3 mujorit të parë të vitit 2019

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R